



Agjencia për mbikëqyrje të financimit  
kapital të sigurimit pensional

BULETINI ELEKTRONIK  
**E-MAPAS**  
**NR.51**

**INFORMOHUNI PËR KURSIMIT  
E JUAJ PENSIONAL DERISA  
JENI TË RINJ!**

TETOR VITI 2024

MAPAS në Ditën e Vetëdijesimit Pensional – 15 shtator rekomandon: “Informohuni për kursimin e juaj pensional derisa jeni të rinj!”

Агенција за супервизија на капитално финансирано пензиско осигурување  
MAPAS

Агенција për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional  
MAPAS

**15 СЕПТЕМВРИ**  
ДЕН ЗА ПЕНЗИСКА СВЕЧНОСТ  
**SHTATORI**  
DITA E VETËDIJËSIMIT PENSIONAL

mapas.mk facebook.com/mapas.mk instagram.com/mapas.mk linkedin.com/mapasmk

Java e Vetëdijesimit Pensional këtë vit është nga 13 deri më 17 shtator, dhe Dita e Vetëdijesimit Pensional është si zakonisht më 15 shtator. Si vazhdimësi e viteve të kaluara, Dita e Vetëdijesimit Pensional të Pensionit ka për qëllim të nxjerrë në pah rëndësinë e kursimeve pensionale.

Në suazat misionit të vet që t'i mbrojnë interesat e anëtarëve të fondeve pensionale dhe ta nxitë zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional për ditë më të sigurta në pension, Agjencia e Financimit Kapital të Sigurimit Pensional – MAPAS e feston Ditën e Vetëdijesimit Pensional – 15 Shtatorin me një sërë aktivitete duke i shfrytëzuar mjetet elektronike të komunikimit dhe mediat sociale, qëllimi i të cilës është ngritja e vetëdijes publike për sistemin pensional. MAPAS në aktivitetet e veta edukative thekson se është me rëndësi të veçantë që të rinjtë të informohen në kohë për të drejtat, obligimet dhe fitimet e anëtarëve të fondeve të obligueshme dhe vullnetare të pensionit, menjëherë pas fillimit të marrëdhënies së punës.

UNË NUK MUND TA NDRYSHOJ  
DREJTIMIN E ERËS, POR MUND T'I  
PËRSHTATI KRAHËT E MI  
GJITHMONË QË TA ARRIJ  
DESTINACIONIN QË DËSHIROJ.

XHIMI DIN

PUNA E MADHE NË KËTË BOTË  
NUK ËSHTË KU QËNDROJMË,  
POR NË CILËN KAHJE LËVIZIM.

OLIVER VENDEL HOLMS

"Informohuni për kursimin e juaj pensional derisa jeni të rinj!", është mesazhi të cilin MAPAS ua dërgon vazhdimisht qytetarëve. Duam të theksojmë se kursimi pensional është investim afatgjatë, kurse MAPAS kontribuon dhe do të vazhdojë të kontribuojë në përfundimin e vazhdueshëm të kursimeve individuale nëpërmjet sigurimit të menaxhimit me rreziqet të cilat u kërcënohen mjeteve dhe pensioneve dhe kompensimeve pensionale të anëtarëve të fondeve pensionale, si dhe të reputacionit të sistemit, dhe reduktim të tyre në nivelin më të ulët të mundshëm.

Me rastin e Ditës së Vetëdijesimit Pensional, të diel, më 15 shtator, me mbështetje nga MAPAS, shoqëritë pensionale Trigllav, Sava dhe KB Prvo do të organizojnë "Eveniment familjar" me qëllim që të promovojnë dhe edukojnë publikun për financimin kapital të sigurimit pensional. Evenimenti ka karakter të hapur në afërsi të kafenesë "Mambo" në parkun "Avionçe" në Komunën Aerodrom. Gjatë ditëve të vetëdijesimit pensional, shoqëritë pensionale organizuan një sërë seminare dhe vebinare online, ku ekspertë të fushës së sigurimeve pensionale informuan qytetarët për aspektet e ndryshme të kursimeve pensionale, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të fondeve pensionale, si dhe sa i përket risive në rregullore .

Aktivitetet dhe iniciativat e MAPAS-it gjatë vitit 2024 për edukimin publik:

- E-postime dhe banderola: Këtë vit, MAPAS u fokusua në fushatat dixhitale, duke përdorur e-post dhe banderola në mediat sociale dhe faqet e internetit për të rritur vetëdijësimin për kursimet e pensionit. Këto postime përfshijnë grafika informative, video dhe përmbajtje interaktive që shpjegojnë përfitimet e sigurimit pensional me financim kapital.
- Java Globale e Parasë 2024: Mesazhi për Javën Globale e Parasë së këtij viti ishte "Kurseni paratë tuaja, siguroni të ardhmen tuaj". MAPAS së bashku me shoqëritë pensionale KB Shoqëria e parë pensionale SHA Shkup, Shoqëria pensionale SAVA a.d. Shkupi dhe kompania pensionale TRIGLAV SHA Shkup, këtë vit realizuan aktivitete dhe në kuadër të të njëjtit shpallën konkurs artistik i cili ishte i dedikuar për të gjithë fëmijët e moshës 4 deri në 14 vjeç si aktivitete edukative për shënimin e "JAVËS GLOBALE E PARASË 2024". Gjithashtu, janë mbajtur disa ligjërata edukative për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, si dhe për studentët, për të cilët është organizuar një ngjarje e madhe së bashku me Kuvendin Studentor Universitar i cili është mbajtur më 25.03.2024, në të cilin studentët qëllim i të cilës ishte vetëdijësimi i kolegëve të tyre për përfitimet e njohjes së tregut financiar dhe institucioneve financiare nga Fakulteti Ekonomik, ata përcollën përvojën e tyre personale me praktikën e kryer në MAPAS dhe shoqëritë pensionale.
- "Mirë se vini "brucoshë - Ora e parë akademike e UKIM" - MAPAS së bashku me shoqëritë pensionale KB Shoqëria e parë pensionale SHA Shkup, Shoqëria pensionale SAVA a.d. Shkupi dhe shoqëria pensionale TRIGLAV SHA Shkup morën pjesë në manifestimin për fillimin e vitit të ri akademik për të gjithë studentët e vitit të parë në Universitetin "St. Kirili dhe Metodi" (UKIM)".



## KUMTESË PËR PJESËMARRJE NË KONFERENCËN E 23-TË VJETORE TË BURSËS MAQEDONASE

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional mori pjesë në konferencën e 23-të vjetore të Bursës Maqedonase. Një nga panelet e konferencës ishte për "Investitorët e brendshëm institucionalë dhe Bursën", ku mori pjesë Darko Sazdov nga Agjencia, anëtar i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë. Në panel u diskutua mbi gjendjen në sistemin pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut në krahasim me rajonin dhe më gjerë në vendet e OECD-së.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.





## PJESËMARRJA E PUNONJËSVE TË MAPAS-IT NË MARATONËN JUBILARE TË 20-TË TË WIZ AIR MARATONA NË SHKUP

Me krenari ju njoftojmë se punonjësit e MAPAS-it morën pjesë në edicionin e njëzetë të Maratonës së Shkupit e cili u mbajt më 6 tetor 2024. Ekipi ynë morri pjesë në disiplinat – gara e vrapimit të ekipit në 5 kilometra dhe gjysmë maratonë.

Për më shumë informacione vizitoni **linkun** e mëposhtëm.



ПРЕЗЕМИ ОДГОВОРНОСТ  
ЗА ТВОЈАТА ПЕНЗИЈА!

ИНФОРМИРАЈ СЕ НА

[www.mapas.mk](http://www.mapas.mk) [f](https://www.facebook.com/mapas.mk) [i](https://www.instagram.com/mapas.mk) [in](https://www.linkedin.com/company/mapas.mk) [yt](https://www.youtube.com/channel/UC...)



### KENI PYETJE OSE ANKESA?

Paraqituni në MAPAS ose shkruani një mesazh në [contact@mapas.mk](mailto:contact@mapas.mk)

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)  
Slavko Janevski 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut  
Tel: (02) 3224 229  
[www.mapas.mk](http://www.mapas.mk)



[www.mapas.mk](http://www.mapas.mk)



[mapas.mk](https://www.facebook.com/mapas.mk)



[mapas.mk](https://www.instagram.com/mapas.mk)



[mapasmk](https://www.linkedin.com/company/mapas.mk)